



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 52, datë 26.09.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES

“Mbi Organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “f” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 13, pika 1 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Stabilitetit Financiar me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

RREGULLORE

“MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DEPARTAMENTIT TË STABILITETIT FINANCIAR”

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Bankës së Shqipërisë

nr. 52, datë 26.09.2007

Tiranë, Shtator 2007

KREU I

Të përgjithshme

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit, të funksionimit dhe të kompetencave të veprimtarisë së Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Neni 2

Baza juridike

Departamenti i Stabilitetit Financiar kryen detyrat e tij në bazë dhe në zbatim të:

- a) ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- b) ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) Statutit të Bankës së Shqipërisë;
- d) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “**Departamenti**” – është Departamenti i Stabilitetit Financiar.
- b) “**Administrator**” – është Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë.
- c) “**Këshilli Mbikëqyrës**” – është Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- d) “**Banka**” – është Banka e Shqipërisë.
- e) “**Njësia**” – është zyra ose sektori, që është pjesë përbërëse e strukturës organizative të departamentit.

KREU II

Organizimi i Departamentit

Neni 4

Struktura organizative

Në përputhje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës “Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë”, departamenti ka në strukturën e tij organizative:

1. Sektorin e Tregjeve Financiare, të Infrastrukturës dhe të Administrimit të Krizave, i përbërë nga:
 - a) Zyra e Infrastrukturës; dhe
 - b) Zyra e Tregjeve Financiare dhe e Administrimit të Krizave.
2. Sektorin e Vlerësimit të Rrezikut Makroprudencial.

Neni 5

Drejtimi

1. Departamenti drejtohet nga Drejtori, i cili është përgjegjës për administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së departamentit.
2. Drejtori i departamentit e drejton departamentin me ndihmën e Zëvendësdrejtorit dhe/ose Përgjegjësit të Sektorit.
3. Në mungesë ose në pamundësi objektive për të ushtruar detyrat nga Drejtori, departamenti përfaqësohet në përputhje me rregulloren “Mbi rregullat proceduriale të Bankës së Shqipërisë”.

Neni 6

Varësia

1. Departamenti është në varësi të drejtpërdrejtë administrative të Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës.
2. Drejtori i Departamentit përgjigjet përpara Zëvendësguvernatorit të Dytë, dhe në rastet kur kërkohet nga Guvernatori, edhe përpara këtij të fundit.
3. Zëvendësdrejtori dhe/ose Përgjegjësi i Sektorit përgjigjet përpara Drejtorit. Në mungesë të Drejtorit, Përgjegjësi i Sektorit përgjigjet përpara Zëvendësdrejtorit.

4. Specialisti i Departamentit, në përputhje me strukturën organizative të departamentit, përgjigjet përkatësisht përpara Përgjegjësit të Sektorit, Zëvendësdrejtorit dhe përpara Drejtorit.

KREU III

Funksionimi dhe detyrat e Departamentit

Neni 7

Qëllimi dhe detyrat kryesore të Departamentit

1. Departamenti ka për qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar, nëpërmjet zbatimit të metodave të ndryshme dhe realizimit të analizave, në të cilat përcaktohet lloji dhe madhësia e rreziqeve sistemike që i kanosen sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij, si rezultat i ndikimit të zhvillimeve që ndodhin në tregjet financiare dhe në pjesëmarrësit e tyre, me të cilët sistemi financiar ndërvepron.
2. Departamenti, brenda funksionit të tij, propozon pranë administratorëve të Bankës ndërmarrjen e veprimeve të cilat synojnë trajtimin e rreziqeve sistemike dhe të pasojave që rrjedhin nga ngjarje të ndryshme, që çenojnë mirëfunksionimin e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar.
3. Departamenti, sipas frekuencës së nevojshme, ka të drejtën të kërkojë nga departamentet e tjera të Bankës dhe nga institucione të tjera që rregullojnë, që mbikëqyrin, që vlerësojnë dhe që analizojnë ecurinë e sistemit financiar, të dhëna, informacione dhe bashkëpunim për vlerësimin e zhvillimeve të përgjithshme dhe të dukurive të vërejtura gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushat e tyre të kompetencës, si edhe për ndryshimet e mundshme në kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës.
4. Departamenti, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera të Bankës, propozon llojin dhe formën e marrjes së të dhënave që i nevojiten sipas pikës 3.
5. Departamenti, për sigurimin e të dhënave dhe të informacionit nga institucione të tjera sipas pikës 3, vlerëson nevojën për vendosjen e marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit me këto institucione, nxit strukturat drejtuese të Bankës për realizimin e tyre dhe merr pjesë në procesin e hartimit të këtyre marrëveshjeve.
6. Departamenti, për trajtimin e pasojave që rrjedhin nga ngjarje të ndryshme që çenojnë mirëfunksionimin e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar, sipas pikës 2, sipas rastit dhe përgjegjësi që iu takojnë autoriteteve të ndryshme që ndjekin zhvillimet në tregun financiar, vlerëson nevojën për realizimin e procedurave dhe të marrëveshjeve, si edhe për ngritjen e grupeve të posaçme të punës – brenda Bankës ose ndër-institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Departamenti nxit strukturat drejtuese të Bankës për realizimin e këtyre masave dhe merr pjesë në hartimin e tyre.

7. Informacioni që disponohet në departament, grupohet, përpunohet, regjistrohet në një bazë të dhënash, kategorizohet, si edhe trajtohet sipas kërkesave të rregulloreve përkatëse të transparencës dhe të konfidencialitetit.
8. Çdo njësi e departamentit përgatit informacione të ndryshme, periodike dhe të veçanta, të cilat kërkohen nga Drejtori i Departamentit, nga administratorët ose nga Këshilli Mbikëqyrës, lidhur me çështjet që shqyrton si rezultat i funksionit që kryen.
9. Departamenti kryen edhe detyrat e mëposhtme:
 - a) harton Raportin e Stabilitetit Financiar, i cili analizon zhvillimet me rëndësi të sistemit financiar gjatë një viti kalendarik dhe evidenton faktorët që përfaqësojnë rrezik sistemik. Raporti paraqitet në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, jo më vonë se gjashtë muaj pas nxjerrjes së të dhënave të fundit të vitit. Struktura e përmbajtjes së Raportit të Stabilitetit Financiar, miratohet nga administratorët brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik;
 - b) koordinon punën për hartimin e deklaratës “Mbi stabilitetin e sistemit financiar” çdo gjashtë muaj dhe e paraqet atë në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, jo më vonë se tre muaj pas nxjerrjes së të dhënave të fundit të gjashtëmujorit;
 - c) kontribuon në përgatitjen e Raportit dhe të Bilancit Financiar të Bankës;

Neni 8

Funksionet dhe detyrat e Sektorit të Tregjeve Financiare, të Infrastrukturës dhe të Administrimit të Krizave

Sektor i Tregjeve Financiare, i Infrastrukturës dhe i Administrimit të Krizave, për kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të departamentit, të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, nëpërmjet njësive që e përbëjnë, analizon formën dhe madhësinë e rrezikut që i kanoset mirëfunksionimit të të gjithë sistemit financiar, si rezultat i zhvillimeve në tregjet financiare, në institucionet pjesëmarrëse dhe në infrastrukturën e tyre. Gjithashtu, në emër të Bankës, ky sektor kontribuon në administrimin e krizave financiare në bazë të marrëveshjeve të realizuara me institucione të tjera.

Neni 9

Zyra e Infrastrukturës

Zyra e Infrastrukturës për kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të departamentit, të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje kryen detyrat si më poshtë:

- a) monitoron dhe analizon, duke përdorur në përgjithësi tregues të agreguar, burimet kryesore të paqëndrueshmërisë së mundshme të institucioneve financiare bankare dhe jobankare;
- b) vlerëson ndjeshmërinë e institucioneve financiare bankare dhe jobankare, kryesisht me rëndësi sistemike, nëpërmjet përdorimit të *shock*-eve të jashtëzakonshme por të mundshme, duke përdorur teknika statistikore të posaçme, si *stress test* etj.;
- c) planifikon, zhvillon dhe zbaton sisteme të paralajmërimit të hershëm duke përdorur modele statistikore;
- d) vlerëson, në përgjithësi, efektin e adoptimit të standardeve ndërkombëtare në sektorin bankar dhe jobankar;
- e) analizon infrastrukturën financiare nga këndvështrimi ligjor dhe nga cilësia e sistemeve të pagesave. Për këtë:
 - i. monitoron zhvillimet e kuadrit rregullativ financiar dhe vlerëson në mënyrë të përgjithshme, përputhshmërinë e tij me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, dhe sipas rastit, nxit përshtatshmërinë me këto standarde dhe praktika,
 - ii. vlerëson, në përgjithësi, përshtatshmërinë e funksionimit të sistemeve të pagesave me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira;
- f) harton dhe paraqet përpara strukturave drejtuese të Bankës ose përpara strukturave të tjera vendase dhe të huaja, raporte, analiza dhe studime mbi dinamikën e zhvillimit të sektorëve bankarë dhe jobankarë, dhe mbi çështje të stabilitetit financiar, që mbulohen prej tij;
- g) harton opinione mbi projektakte juridike që nxirren nga banka ose autoritete të tjera publike, për çështje të stabilitetit financiar që mbulohen prej tij;
- h) krijon dhe administron bazën e të dhënave që shfrytëzohet për analiza të çështjeve që lidhen me stabilitetin financiar dhe që mbulohen prej tij;
- i) bashkëpunon me struktura ose institucione të tjera kompetente vendase dhe të huaja, për çështjet që lidhen me stabilitetin financiar të sektorëve bankarë dhe jobankarë;
- j) kontribuon në hartimin e Raportit të Stabilitetit Financiar dhe në raporte të tjera të Bankës, për çështje që mbulohen prej tij;
- k) analizon raporte dhe dokumente të politikave që zbatohen për stabilitetin financiar dhe që nxirren nga institucione të huaja si edhe përgatit vlerësime të përmbledhura, me qëllim informimin e strukturave drejtuese të Bankës për këto çështje.

Neni 10

Zyra e Tregjeve Financiare dhe e Administrimit të Krizave

Zyra e Tregjeve Financiare dhe e Administrimit të Krizave, për kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të departamentit, të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, kryen detyrat si më poshtë:

- a) analizon qëndrueshmërinë, eficiencën dhe konkurrencën e tregut të brendshëm financiar. Për këtë:
 - i. përcakton treguesit kryesorë për analizimin e tregjeve financiare;
 - ii. krijon dhe mban bazën e të dhënave që i shërben analizës së tregjeve financiare,
 - iii. identifikon burimet e rrezikut të funksionimit të tregjeve financiare;
 - iv. vlerëson madhësinë e burimeve të rrezikut dhe mundësinë që ato të shndërrohen në rrezik sistemik,
 - v. analizon dinamikën e rreziqeve që janë specifike për tregjet financiare, duke përfshirë rrezikun e likuiditetit dhe atë të përcjelljes së krizave financiare (*contagion*),
 - vi. vlerëson shkallën e ndërmjetësimit të tregjeve financiare për ekonominë reale,
 - vii. analizon qëndrueshmërinë e tregjeve financiare, ndaj krizave të mundshme,
 - viii. realizon analiza të ndryshme për pasojat që sjellin në qëndrueshmërinë financiare të sistemit financiar vendas, ngjarje dhe zhvillime të ndryshme brenda vendit dhe në tregjet ndërkombëtare financiare;
- b) identifikon politikat dhe masat e nevojshme për ruajtjen ose rivendosjen e qëndrueshmërisë në funksionimin e tregjeve të brendshme financiare dhe në infrastrukturën e tyre;
- c) propozon pranë strukturave drejtuese të Bankës miratimin e politikave dhe hartimin e marrëveshjeve të ndryshme ndërinstitucionale, me qëllim administrimin e krizave financiare; monitoron kontributin e përgjithshëm të Bankës në këto procese, si edhe koordinon punën brenda Bankës për përgatitjen e institucionit për të tilla situata;
- d) kontribuon në hartimin e Raportit të Stabilitetit Financiar dhe në raporte të tjera të Bankës, për çështje që mbulohen prej tij;
- e) sipas rastit dhe nevojës, merr pjesë në vlerësime që i bëhen sistemit financiar vendas, nga institucionet ndërkombëtare;
- f) jep opinione rreth iniciativave legjislative që nxiten nga banka dhe entitete të tjera publike, e që lidhen me çështje të stabilitetit financiar;
- g) shërben si monitoruese dhe ndjekëse e zbatimit të kërkesave të ndryshme që i referohen marrëveshjeve të bashkëpunimit të realizuara me autoritete të tjera publike, vendase dhe të huaja, sipas pikës 6 të nenit 7.

Neni 11

Funksionet dhe detyrat e Sektorit të Vlerësimit të Rrezikut Makroprudencial

1. Sektori i Vlerësimit të Rrezikut Makroprudencial për kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të Departamentit, të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, analizon formën dhe madhësinë e rreziqeve që kërcënojnë mirëfunksionimin e të gjithë sistemit financiar, si rezultat i zhvillimeve në kuadrin e përgjithshëm makroekonomik, në sektorin real dhe në aktorët e tij.
2. Për të realizuar funksionin sipas pikës 1, Sektori i Vlerësimit të Rrezikut Makroprudencial, kryen këto detyra:
 - a) analizon rrezikun që kërcënon stabilitetin financiar, si rrjedhojë e zhvillimeve në sektorët e biznesit dhe të individëve. Për këtë:
 - i. zhvillon instrumentet dhe teknikat e nevojshme për analizimin dhe vlerësimin e rrezikut sistemik që buron nga sektorët e biznesit dhe të individëve,
 - ii. identifikon dhe monitoron zhvillimin e faktorëve që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e sektorëve të biznesit dhe të individëve për të shlyer borxhin e tyre,
 - iii. përdor metoda të ndryshme statistikore, për të vlerësuar qëndresën e sektorit të biznesit ndaj rreziqeve të ndryshme.
 - b) analizon ndikimin e kuadrit të brendshëm makroekonomik në stabilitetin financiar;
 - c) analizon zhvillimet ndërkombëtare, të cilat mund të çënojnë stabilitetin financiar. Për këtë:
 - i. analizon dhe monitoron ngjarjet ndërkombëtare që mund të kenë pasoja sistemike në ekonominë e brendshme,
 - ii. analizon dhe monitoron zhvillimet në ekonominë ndaj të cilave sektori real i brendshëm dhe sistemi financiar janë të ekspozuar në një nivel të rëndësishëm,
 - iii. analizon dhe monitoron zhvillimet në tregjet e huaja financiare dhe të kreditit, që kanë rëndësi për sistemin e brendshëm financiar;
 - d) analizon zhvillimet në çmimet e mjeteve jofinanciare;
 - e) zhvillon dhe administron një bazë të dhënash, që është e nevojshme për çështje të stabilitetit financiar që ndjek;
 - f) drejton punën dhe realizon hartimin e Raportit të Stabilitetit Financiar;
 - g) kontribuon në raporte të tjera të Bankës, për çështje që mbulohen prej tij.

Neni 12

Përbushja e detyrave të njësive përbërëse të departamentit

Drejtori i departamentit në rastet kur e vlerëson të arsyeshme, ngarkon punonjësit e një njësie përbërëse me përbushjen e detyrave të cilat janë në kompetencë të njësisë tjetër përbërëse, me qëllim realizimin e plotë dhe në kohë të detyrave të planifikuara të departamentit.

Neni 13

Detyrat e drejtorit të departamentit

1. Drejtori i departamentit ka për detyrë:
 - a) të organizojë dhe të drejtojë punën, si edhe të mundësojë kushte normale me qëllim përbushjen e plotë dhe brenda afateve të detyrave të departamentit;
 - b) të përcaktojë mënyrën e përbushjes së detyrave si dhe procedurat për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme në departament;
 - c) të informojë Zëvendësguvernatorin e Dytë mbi realizimin e detyrave kryesore të departamentit dhe Guvernatorin, në rastet kur i kërkohet nga ky i fundit;
 - d) të përfaqësojë departamentin në marrëdhëniet me organet e Bankës, me departamente të tjera dhe me institucione të tjera;
 - e) të realizojë detyra dhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara në Statutin e Bankës.
2. Në bashkëpunim me Zëvendësdrejtorin dhe/ose Përgjegjës të Sektorit:
 - a) organizon punën e njësive përbërëse të departamentit;
 - b) krijon kushtet për funksionimin sa më të mirë të njësive përbërëse dhe vlerëson përbushjen e detyrave;
 - c) organizon bashkëpunimin midis njësive përbërëse të departamentit, si dhe bashkëpunimin me departamentet e tjera dhe me njësitë e tjera organizative;
 - d) përcakton nevojat e punonjësve të departamentit për kualifikime.

Neni 14

Detyrat e Zëvendësdrejtorit dhe/ose të përgjegjës të sektorit të departamentit

1. Zëvendës drejtori dhe/ose përgjegjësi i sektorit ka për detyrë:

- a) të njohë hollësisht fushën e veprimtarisë së njësisë përbërëse ku ai punon dhe të departamentit në përgjithësi;
- b) të mundësojë kushte normale për funksionimin efektiv të njësisë që drejton;
- c) të analizojë kryerjen e detyrave, të informojë Drejtorin mbi punën e kryer si dhe të paraqesë opinione në lidhje me to;
- d) të kontrollojë, të analizojë dhe të informojë mbi rezultatet e punës të punonjësve në varësinë e tij;
- e) të paraqesë për miratim/nënshkrim tek Drejtori, manualët e vendit të punës të vartësve të tij, të cilat miratohen nga Zëvendësguvernatori i Dytë;
- f) të zbatojë detyrat e ngarkuara sipas rregulloreve në fuqi, manualit përkatës të vendit të punës si dhe të planeve të punës të miratuara nga Zëvendësguvernatori i Dytë;
- g) të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e punës, të japë instruksione dhe ndihmën e domosdoshme për vartësit e tij në përmbushjen e detyrave;
- h) të nënshkruajë dokumentet e hartuara nga punonjësit që ka në varësi të tij, të cilat i paraqiten për nënshkrim Drejtorit të departamentit;
- i) të mbikëqyrë respektimin nga vartësit e tij të kuadrit rregullativ të Bankës;
- j) të kryejë detyra të tjera të caktuara nga Drejtori i departamentit.

Neni 15

Detyrat e specialistit të departamentit

Specialisti i departamentit ka për detyrë:

- a) të njohë hollësisht fushën e veprimtarisë së njësisë përbërëse ku ai punon dhe të departamentit në përgjithësi;
- b) të zbatojë detyrat e ngarkuara sipas rregulloreve në fuqi, manualit përkatës të vendit të punës si dhe planeve të punës të miratuara nga Zëvendësguvernatori i Dytë;
- c) të informojë eprorin direkt mbi rezultatet e punëve në vazhdim dhe mbi vështirësitë e ndeshura në lidhje me to;

- d) të rrisë kualifikimin e tij profesional në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, duke synuar sjelljen e risive në punën e tij të përditshme;
- e) të respektojë kuadrin rregullator në fuqi të Bankës;
- f) të ruajë, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës, sekretin dhe konfidencialitetin e informacionit, me të cilin është njohur për shkak të detyrës, si dhe të mos e përdorë atë për përfitime personale, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të Bankës;
- g) të respektojë rregullat e etikës në kontaktet zyrtare me eprorët dhe me kolegët e tij si dhe të përfaqësojë në mënyrën e duhur Departamentin dhe Bankën.

Neni 16

Marrëdhëniet midis njësive përbërëse të departamentit

1. Drejtori, Zëvendësdrejtori dhe/ose Përgjegjësi i Sektorit bashkëpunojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e detyrave të planifikuara dhe të atyre shtesë të departamentit.
2. Bashkëpunimi, sipas pikës 1, është i nevojshëm edhe për:
 - a) përmbushjen e detyrave të përbashkëta, të cilat janë detyra të të gjitha njësive përbërëse të departamentit. Nisma për bashkëpunim i takon njësisë përbërëse përgjegjëse për kryerjen e detyrës;
 - b) vendosjen në dispozicion të materialeve dhe dhënien e ndihmës së domosdoshme për njësitë e tjera përbërëse të departamentit, për përmbushjen e duhur të detyrave;
 - c) krijimin e marrëdhënieve të duhura të punës në departament.

Neni 17

Marrëdhëniet me departamentet e tjera, me institucionet e tjera dhe format e bashkëpunimit

1. Me qëllim përmbushjen e detyrave dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të Bankës, departamenti bashkëpunon me:
 - a) departamente të tjera të Bankës;
 - b) institucione të tjera, vendase dhe të huaja, që veprojnë në industrinë bankare dhe financiare, si edhe në rregullimin, në mbikëqyrjen dhe në vlerësimin e tregut financiar.

2. Departamenti bashkëpunon me departamentet dhe njësitë e tjera organizative të Bankës, kur detyrat e tyre lidhen midis tyre nëpërmjet:
 - a) kontakteve personale të personelit, sipas përkatësisë;
 - b) përcjelljes së ndërsjelltë të informacionit;
 - c) pjesëmarrjes në projekte dhe grupe pune;
 - d) bashkëpunimit në njohjen, në analizimin dhe në trajtimin e çështjeve të përbashkëta, në lidhje me detyrat që ata kryejnë.
3. Për çdo formë të bashkëpunimit, vihet në dijeni paraprakisht dhe/ose merret miratimi i Drejtorit ose Zëvendësdrejtorit dhe/ose përgjegjësit të sektorit.
4. Për çdo formë të bashkëpunimit, hartohet informacioni përkatës lidhur me ecurinë dhe me rezultatin e bashkëpunimit, i cili ruhet në departament, në njësinë e cila ka marrë nismën ose ka marrë pjesë drejtpërdrejt në bashkëpunim.

KREU IV

Dispozita të fundit

Neni 18

Zbatimi

1. Ngarkohen punonjësit e departamentit për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të akteve të tjera të miratuara në zbatim të saj.
2. Zëvendësguvernatori i Dytë miraton manualet e vendit të punës për çdo punonjës duke u mbështetur në këtë rregullore.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

Ardian Fullani